

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

PROPOZUES: Shërbimi profesional i Fondit

PËRGATITËS: Sektori për çështje financiare

RAPORTUES: Ajredin Amzai, ndih.drejtor

PROPOZIM - VENDIM

**për miratimin e Llogarisë përfundimtare të Fondit për sigurim pensional dhe
invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2018**

Shkup, shkurt viti 2019

Në bazë të nenit 157 pika 4 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 98/12; 166/12; 15/13 и 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 13/16, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18) dhe neni 24 nga Ligji për kontabilitet të Buxhetit dhe shfrytëzuesve të buxhetit ("Gazeta zyrtare e RM-së " nr.61/02, 98/02, 81/05 dhe 24/11), Këshilli drejtues i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 27 shkurt të vitit 2019, solli

V E N D I M

për miratimin e Llogarisë përfundimtare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2018

Neni 1

Miratohet Llogaria përfundimtare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor e Maqedonisë së Veriut për vitin 2018 (në tekstin e mëtejme: Fond), me të hyrat dhe dalat në vijim:

	Të planifikuara	Në denarë Të realizuara
Gjithsej të hyra	68.645.000.000,00	68.852.469,300,00
Mjete të bartura prej vitit 2017		1.353.448.698,00
Gjithsej të dala	68.645.000.000,00	68.544.213.452,00
Tepricë të të dalave		1.661.704.546,00

Neni 2

Të hyra të planifikuara dhe realizuara sipas burimeve të të hyrave dhe të dalat përfundimtare sipas qëllimeve bazë të përcaktuar, edhe atë:

Shifra	LLOJI I TË HYRAVE GJEGJËSISHT TË DALAVE	RIBALANCI I BUXHETIT 2018 me bartjen e	REALIZUAR NË VITIN 2018
1	2	3	4
	BILANCI I TË HYRAVE	68.645.000.000,00	68.862.469.300,00
	TË HYRA BURIMORE	39.105.000.000,00	39.337.369.676,00
712	Kontribute nga pagat për fonde sociale	37.810.000.000,00	37.990.407.657,00
712111	Kontribut nga përfitimi për SPI për stazh sigurimi e cila konsiderohet me kohëzgjatje të shtuar	449.000.000,00	442.618.596,00
712113	Kontribut nga pagat për SPI për punëtorë tek personat juridik	32.870.600.000,00	33.906.869.100,00
712114	Kontribut nga pagat e të punësuarve tek personat fizik të cilët kryejnë veprimtari të pavarur	118.860.000,00	0,00
712116	Kontribut për SPI të personave fizik të cilët kryejnë veprimtari të pavarur	669.960.000,00	821.541.995,00
712117	Kontribut për vazhdim të sigurimit pensional dhe invalidor	24.690.000,00	18.618.883,00
712121	Kontribut për SPI për të punësuar tek organet e huaj dhe ndërkombëtar, organizat, përfaqësi diplomatike dhe konzulare	312.930.000,00	170.706.273,00
712122	Kontribut për SPI për vitet e kaluara	2.937.320.000,00	2.238.879.710,00
712124	Kontribut për SPI për bujq individual	138.000.000,00	136.154.433,00
712125	Kontribut për SPI të cilën e paguan FSPIM për shfrytëzuesit e kompensimit në bazë të invaliditetit	0,00	11.535,00
712411	Kontribut për SPI të cilën e paguan Agjencioni për punësim i RMV-së i personave të papunë	9.500.000,00	7.895.994,00
712412	Kontribut për SPI për pushim mjekësor mbi 21 dit nga Fondi i sigurimit shëndetësor	276.850.000,00	247.111.138,00
712413	Kontribut për SPI që e paguan FSPIMV për shfrytëzuesit e kompensimit në bazë të invaliditetit	1.140.000,00	
712414	Kontribut nga SPI që e paguan Qendra për punë sociale dhe koompensim për pagë për orar të shkurtër pune për shkak të kujdesit të fëmijës me hendikon	1.150.000,00	0,00
714	TATIME TË VENDIT TË MALLRAVE DHE SHËRBIME	1.295.000.000,00	1.346.962.019,00
714212	Akcizë të benzinës motorike	1.295.000.000,00	1.346.962.019,00
72	TË HYRA JO TATIMORE	132.000.000,00	112.715.089,00
721	Të hyra sipërmarrëse dhe të hyra nga prona	0,00	251,00
721311	Kamata nga depozita në bankat komerciale		251,00
723	Taksat dhe kompensimet	26.000.000,00	27.271.724,00
723911	Qiratë nga objektet	26.000.000,00	27.271.724,00
725	Të hyra tjera jotatimore	106.000.000,00	85.443.114,00
7259	Të hyrat e mbetura jotatimore	106.000.000,00	85.443.114,00
73	TË HYRAT KAPITALE	4.000.000,00	3.547.127,00
734	Të hyra nga dividendat	4.000.000,00	3.547.127,00
734111	Dividenda në bazë të aksioneve të arritura nga transformimi	4.000.000,00	3.547.127,00
74	TRANSFERE DHE DONACIONE	29.399.000.000,00	29.391.980.994,00
741	Transfere nga nivele të tjera të qeverisjes	29.399.000.000,00	29.391.980.994,00
741111	Transfere rrjedhëse nga nivele të tjera të qeverisjes	121.500.000,00	115.449.114,00
741112	Transfere nga buxheti i RM-së	29.277.500.000,00	29.276.531.880,00

77	SHITJA E LETRAVE ME VLERË	5.000.000,00	16.856.414,00
771	Shitja e letrave me vlerë	5.000.000,00	16.856.414,00
771212	Të hyra nga shitja e pjesëve, aksioneve dhe letrave tjera me vlerë	5.000.000,00	16.856.414,00
	GJITHSEJ TË DALA	68.645.000.000,00	68.544.213.452,00
	TË DALA AKTUALE	68.645.000.000,00	68.544.213.452,00
40	Pagat, qiratë dhe kompensimet e të punësuarve	233.000.000,00	232.192.272,00
401	Pagat kryesore dhe kompensimet	168.298.000,00	167.915.494,00
402	Kontribute për sigurim social nga punëdhënësit	62.402.000,00	62.045.751,00
404	Kompensime	2.300.000,00	2.231.027,00
42	MALLRA DHE SHËRBIME	143.332.000,00	120.454.610,00
420	Të dalat e udhëtimit dhe ditore	1.880.000,00	874.585,00
421	Shërbimet komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	52.497.000,00	50.931.033,00
423	Inventari i imët, mjetet dhe materiale tjera për riparime	11.304.000,00	10.591.838,00
424	Riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse	29.043.000,00	26.174.049,00
425	Shërbime kontraktuese	29.520.000,00	28.259.997,00
426	Të dala tjera rrjedhëse	19.088.000,00	3.623.108,00
46	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	16.168.000,00	15.013.904,00
463	Transfere deri në organizatat joqeveritare	2.000.000,00	472.777,00
464	Transfere të ndryshme	2.010.000,00	1.366.697,00
465	Pagesë në bazë të dokumenteve ekzekutive	12.158.000,00	13.174.430,00
47	BENEFICIONET SOCIALE	68.226.000.000,00	68.153.124.440,00
472	Pagesa e beneficioneve nga Fondi i SPIMV-së	68.226.000.000,00	68.153.124.440,00
472110	Pagesa deri tek pensionistët nga Fondi i SPIMV-së	53.867.000.000,00	53.912.048.266,00
472210	Pagesë deri tek invalidët nga Fondi i SPIMV-së	4.000.000,00	3.774.175,00
472310	Pagesë në bazë të sigurimit të detyrueshëm social me financim kapital	7.075.000.000,00	7.007.817.737,00
472410	Kontributi i sigurimit shëndetësor për shfrytëzuesit e nensionit	6.830.000.000,00	6.827.334.262,00
472910	Pagesat për Fondin solidar për shfrytëzuesit e ndierë të nensionit	450.000.000,00	402.150.000,00
48	TË DALA KAPITALE	26.500.000,00	23.428.226,00
480	Blerje e pajisjeve dhe makinave	11.900.000,00	11.283.342,00
481	Objektet ndërtimore	8.470.000,00	7.135.452,00
485	Investime dhe mjete jo financiare	4.600.000,00	3.606.884,00
486	Blerja e automjeteve	1.530.000,00	1.402.548,00

Neni 3

Raporti mbi punën financiare të Fondit për vitin 2018 me të dalat e realizuara është pjesë përbërëse e këtij vendimi

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e sjelljes.

Nr. 02-
.02.2019
Shkup

KRYETAR
I KËSHILLIT DREJTUE
Boro Varoshlija

R A P O R T

për punën financiare të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2018

Me Buxhetin e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2018 si dhe dy Ribalancet e Buxhetit për vitin 2018 i miratuar më 11 nëntor të vitit 2017, si pjesë përbërëse e Buxhetit të Vendit, ishte planifikuar që puna financiare e Fondit të realizohet me të hyra dhe të dala të ribalancuara. Si bazë për realizimin e bilancit ndërmjet të hyrave dhe të dalave ishin indikatorët makroekonomik për rritjen e të hyrave nga kontributet për 4,5% (2,4 % nga rritja e parashikuar e pagave dhe 2,1% rritja e punësimit), si dhe sigurimin e mjeteve nga Buxheti i Vendit për obligimet e rregullta, për shpenzimet transitive dhe mbulimin e deficitit të Fondit. Rritja e pagave të të punësuarve është një faktor i rëndësishëm nga i cili llogaritet dhe paguhet kontributi i sigurimit pensional dhe invalidor dhe rritja e punësimit kanë ndikim të rëndësishëm mbi realizimin e lartësisë të të hyrave të Fondit.

Me Buxhetin e Fondit për vitin 2018 ishte paraparë realizimi i gjithsej të hyrave dhe gjithsej të dalave në shumë prej 67.985,00 milion denarë. Shërbimi profesional i Fondit rregullisht ndoqi gjendjen financiare dhe konstatoi se sipas përfundimit në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2018 të hyrat e planifikuara nuk janë kryer në vëllimin e parashikuar, ndërsa të dalat për pagesën e pensioneve janë kryer me rritje mbi mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2018.

Në periudhën janar-shtator të vitit 2018 në realizimin e të hyrave dhe të dalave kishte mosrealizim të të hyrave dhe të dalave të planifikuara dhe Fondi kishte mungesë të mjeteve në shumë prej 422,55 milion denarë për këtë shkak shfrytëzonte hua nga Buxheti i Vendit për pagesën e pensioneve të cilën rregullisht e kthente në muajin aktual të hyrjeve. Për gjendjen e konstatuar janë informuar ministritë kompetente të cilat filluan aktivitetet në kompetencën e tyre për përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Buxhetit të Fondit dhe Buxhetit të Vendit për vitin 2018.

Nga këto arsye është qasur ndaj ndryshimit dhe plotësimit të Buxhetit të Fondit për vitin 2018. Ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të Fondit për vitin 2018 filluan të zbatohen nga nëntori i vitit 2018.

Me ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Fondit për vitin 2018 gjithsej të hyrat dhe gjithsej të dalat janë rritur për 660,00 milion denarë dhe të njëjtat janë vlerësuar në 68.645,00 milion denarë. Ndryshimi i Buxhetit për vitin 2018 kishte të bëjë me rritjen e mjeteve transfere prej 136,50 milion denarë, ndërsa gjithashtu janë zmadhuar edhe të hyrat nga kontributet për 517,50 milion denarë, 5,00 milion denarë të hyra nga akcizat, 1,00 milion denarë të hyra nga dividendat apo gjithsej 660,00 milion denarë, përderisa në pjesën e të dalave janë zmadhuar mjetet për sigurim pensional të detyrueshëm financiar për 404,00 milion denarë, 200,00 milion denarë mjete për pagesën e pensioneve, 56,00 milion denarë kontribut për shëndetësi, 10,07 milion denarë janë mjete të zmadhuara për pagesën e dokumenteve ekzekutuese, ndërsa janë reduktuar mjete për mallra dhe shërbime.

Fondi përveç mjeteve transfere nga Buxheti i Vendit të përcaktuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2018 shfrytëzonte edhe mjete plotësuese në formë të huasë. Lartësia e huasë në periudhën janar-dhjetor të vitit 2018 lëvizte prej 250,00 milion denarë në muajin janar, 350,00 milion denarë në muajin shkurt, 300,00 milion denarë në mars, 450,00 milion denarë në prill, 550,00 milion denarë në maj, 350,00 milion denarë në qershor, 350,00 milion denarë në korrik, 200,00 milion denarë në gusht, 200,00 milion denarë në shtator, 250,00 milion denarë në tetor, 350,00 milion denarë në nëntor dhe 350,00 milion denarë në dhjetor të vitit 2018 apo në mesatare huaja arrinte 329,00 milion denarë në muaj.

Në vitin 2018 gjithsej të hyrat e Fondit pa mjetet e bartura monetare nga viti 2017 (në shumë prej 1.353,45 milion denarë) arrijnë 68.852,47 milion denarë dhe të njëjtat janë mbi nivelin e të hyrave të planifikuara (100,30%) me Ribalancin e Buxhetit të Fondit për vitin 2018, ndërsa në krahasim me vitin 2017 kur arrin 65.319,36 milion denarë janë më të larta për 5,41%. Gjithsej të dalat e Fondit në vitin 2018 arrijnë 68.544,20 milion denarë dhe të njëjtat janë në nivel të të planifikuarave

(99,85%) ndërsa në krahasim me vitin 2017 janë më të larta kur arrin në 65.148,94 milion denarë janë për 5,21% apo për 3.395,26 milion denarë.

Gjithsej të hyrat e realizuara të Fondit në vitin 2018 (68.852,47 milion denarë) së bashku me mjetet e bartura monetare nga viti 2017 (1.352,45 milion denarë) arrijnë 70.205,92 milion denarë, ndërsa gjithsej të dalat arrijnë 68.544,20 milion denarë. Saldoja e mjeteve monetare më 31 dhjetor të vitit 2018 arrin 1.661,70 milion denarë.

I. Gjithsej të hyrat

Gjithsej të hyrat e Fondit në shumë prej 68.852,47 milion denarë janë realizuar edhe atë: nga të hyrat burimore mjete në shumë prej 37.990,40 milion denarë apo 55,18 % nga gjithsej të hyrat, mjete nga Buxheti i Vendit 29.391,94 milion denarë apo 42,69%, nga akcizat 1.346,96 milion denarë apo 1,96%, 3,55 milion denarë të hyra nga dividenda apo 0,005%, 16,86 milion denarë nga shitja e aksioneve dhe pjesëve apo 0,02%, dhe nga të hyra tjera 102,76 milion denarë, apo 0,15%.

1) Të hyrat burimore apo mjetet nga kontributet i përbëjnë edhe atë

- **Kontributi nga paga** në vitin 2018 llogaritet në shkallë prej 18,0% të bruto pagës dhe është burim kryesor për financimin e Fondit. Në kuadër të të hyrave burimore nga kontributet e pagës janë realizuar mjete në shumë prej 36.565,66 milion denarë dhe e njëjta në raport me të planifikuarat me Buxhetin e Fondit shënoi rritje prej 0,46% apo 165,66 milion denarë.

Pjesëmarrja e kontributeve nga paga në gjithsej të hyrat arrin 53,11%. Në vitin 2018 janë paguar gjithsej 101,75 milion denarë kontribute të prapambetura dhe interes në bazë të pagesave të vonuara të kontributeve për SPI deri në vitin 2008, ndërsa për shkak aktivitetit të rritur të seksionit për pagesën e kontributeve.

- **Kontributi nga të hyrat** llogaritet nga pagat e të punësuarve të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar, sipas shkallëve të përcaktuara në varësi të numrit të muajve që llogariten në stazhin e sigurimit. Këto të hyra në vitin 2018 arrijnë 442,61 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të hyrat

marrin pjesë me 0,64%. Të hyrat e realizuara në krahasim me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2018 janë zmadhuar për 1,43% apo në shumë prej 6,39 milion denarë.

- **Të hyrat nga personat fizik që kryejnë veprimtari dhe të punësuarit tek ato** janë realizuar në shumë prej 838,08 milion denarë dhe të njëjtat janë më të larta për 3,02% në krahasim me të planifikuarat, ndërsa si rezultat i më shumë obliguesve të cilët paguajnë kontributet e kësaj kategorie të obliguesve. Pjesëmarrja e këtyre të hyrave në gjithsej të hyrat e Fondit arrin 1,21%.

- **Të hyrat nga kontributet të cilat i paguajnë bujqit individual** janë realizuar në shumë prej 136,15 milion denarë. Tek këta të hyra në vitin 2018 shënohet reduktim prej 1,35% dhe në raport të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit, ndërsa pjesëmarrja e këtyre të hyrave në gjithsej të hyrat e Fondit arrin 0,20%.

- **Të hyrat nga Agjencia e punësimit** dedikohen në bazë të kontributit për personat e papunë të cilët pranojnë kompensim në të holla dhe të cilët nuk kanë të realizuar së paku 15 vjet stazh. Në vitin 2018 sipas kësaj baze janë dedikuar mjete në shumë prej 7,90 milion denarë dhe të njëjtat në krahasim me Buxhetin e vitit 2018 9,50 milion denarë janë më të ulëta për 1,60 milion denarë apo janë kryer me 83,16%. Këto mjete reduktohen çdo vit për shkak reduktimit të numrit të personave për të cilët paguhet kontribut për shkak ndryshimit të dispozitave ligjore të paguhet kontribut vetëm për personat të cilët nuk kanë mbushur 15 vjet stazh pensional. Gjithashtu, në mbështetje të Ligjit për kontributet nga sigurimi i detyrueshëm social, Agjencia e punësimit kontributin për sigurim pensional dhe invalidor e llogarit dhe paguan në shkallë prej 18,0% në neto bazë, në vend që në bruto bazë, të njëjtin e llogarit në kompensim (jo në bazën nga i cili është llogaritur kompensimi). Pjesëmarrja e këtyre të hyrave në gjithsej të hyrat arrin 0,01%.

2. Të hyrat nga akcizat janë të hyra tatimore të cilat realizohen si pjesë e e të hyrave nga akcizat të realizuara nga shitja e derivateve të naftës. Në vitin 2018 janë realizuar në shumë prej 1.346,96 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të hyrat

marrin pjesë me 1,95%. Këto të hyra llogariten në shkallë prej 9,18% nga derivatet e naftës. Të njëjtat janë më të larta për 4,01% në raport me mjetet e planifikuara.

3. Mjetet transfere nga Buxheti i Vendit janë realizuar në shumë prej 29.391,94 milion denarë edhe atë për këto qëllime:

- 3.000,00 milion denarë për pagesën e obligimeve të rregullta të realizuara nën kushte më të volitshme, pensione ushtarake dhe pensione minimale bujqësore;
- 19.419,50 milion denarë për mbulimin e deficitit rrjedhës të Fondit;
- 6.854,96 milion denarë për shpenzimet transitive;
- 115,45 milion denarë nga Ministria e mbrojtjes, ndërsa kanë të bëjnë për pagesën e pensioneve të realizuara sipas Ligjit të armatës; dhe
- 2,03 milion denarë për shpenzimet e paguara të udhëtimit për rekreacion klimaterik në banjë të shfrytëzuesve të pensionit.

Mjetet e realizuara nga Buxheti i Vendit janë realizuar në shumë prej 99,98% me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit. Pjesëmarrja e të hyrave nga Buxheti i Vendit në gjithsej të hyrat e Fondit arrin 42,69%. Mjetet nga Buxheti i Vendit janë të hyra të dyta nga madhësia dhe përfaqësojnë një paragraf të rëndësishëm në financimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

Në vitin 2018, mjetet nga Buxheti i Vendit rregullisht janë dedikuar para pagesës së pensioneve sipas kalkulimeve të Fondit dhe kishin ndikim të rëndësishëm ndaj likuidimit të Fondit, që mundësojnë pagesë të rregullt të pensioneve në afatet e parapara.

4. Të hyrat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve në vitin 2018 janë realizuar në shumë prej 20,41 milion denarë edhe atë:

- nga dividenda janë realizuar mjete në shumë prej 3,55 milion denarë dhe arrijnë 0,005% nga mjetet e planifikuara me Buxhetin e vitit 2018,
- nga shitja e aksioneve dhe pjesëve janë realizuar mjete sepse në vitin 2018 si vit i zgjedhjeve nuk mundeshte të realizohej shitje një periudhë të gjatë dhe për shkak të mos atraksionit të aksioneve dhe pjesëve të cilët ngelin për ashitje.


5. Nga të hyrat e tjera janë realizuar mjete në shumë prej 102,76 milion denarë dhe të njëjtat arrijnë 77,84% me mjetet e planifikuara me Buxhetin e vitit

2018. Të hyrat e tjera kanë të bëjnë edhe atë: 17,27 milion denarë nga të hyrat e qirave, 24,34 milion denarë nga kompensimi i dëmit, 7,46 milion denarë nga pensionet e kthyer nga jashtë, 41,58 milion denarë të hyra të realizuara në periudhë të kaluar, 0,51 milion denarë mjete të kthyer nga devizat e kthyer të pensioneve jashtë vendit 0,09 milion denarë mjete të kthyer nga fondet private, 0,20 milion denarë mjete të kthyer nga Fondi solidar, 9,39 milion denarë nga interesi në bazë të pagesave të vonuara të kontributeve nga SPI dhe 1,92 milion denarë nga të hyrat e tjera.

Mjetet e realizuar sipas llojit të të hyrave paraqiten në vijim:

Nr.R.	Lloji i të hyrave	Ribalanci i Buxheti për vitin 2018	Te realizuara 1-XII 2018	Indeksi 3:2
0	1	2	3	4
1	Kontribut nga paga	36.400,00	36.565,66	100,46
2	Kontribut nga të hyrat	449,00	442,61	98,57
3	Sektori privat	813,50	838,08	103,02
4	Bujq individual	138,00	136,15	98,66
5	Të hyra nga Agjencia e punësimit	9,50	7,90	83,16
	Gjithsej kontribute	37.810,00	37.990,40	100,48
6	Të hyra nga akciza	1.295,00	1.346,96	104,01
7	Transfer nga Buxheti I Vendit	29.399,15	29.391,94	99,98
8	Të hyra tjera	132,00	102,76	77,85
9	Të hyra nga dividendi	4,00	3,55	88,75
10	Të hyra nga shitja e letrave me vlerë	5,00	16,86	337,2
	Gjithsej të hyra	68.645,00	68.852,47	100,30

Struktura e të hyrave është paraqitur në grafikun vijues



Sipas strukturës së paraqitur më e madhe është pjesëmarrja e kontributit nga paga prej 53,11%, i dyti për nga madhësia është transferi nga Buxheti i Vendit me pjesëmarrje prej 42,69% apo sipas të dyjave bazave pjesëmarrja arrin 95,8% derisa nga të gjitha të hyrat e tjera pjesëmarrja arrin 4,2%.

II. Gjithsej të dalat

Gjithsej të dalat e Fondit në vitin 2018 arrijnë 68.544,20 milion denarë dhe të njëjtat në raport të Buxhetit arrijnë 99,85%.

Të dalat e Fondit për vitin 2018 kanë të bëjnë edhe atë për: pagesën e pensioneve, transferin e mjeteve për fondet pensionale private, kompensim për dëmtim trupor, kompensimet nga sigurimi invalidor dhe vendosja në internat e fëmijëve invalid, kontributi për sigurim shëndetësor, kompensim të Shërbimit profesional të Fondit, shpensimet tjera, të dalat kapitale, rikonstruimi i objekteve afariste të Fondit dhe furnizimi i automjeteve.

1. Të dalat për pension arrijnë 54.227,72 milion denarë apo 79,11% në raport të gjithsej të dalave, ndërsa në raport të mjeteve të planifikuara me Buxhetin kryerja arrin 99,83%.

Të dalat për pensione kanë të bëjnë, edhe atë: 53.865,90 milion denarë apo 99,33% për pagesën e pensioneve të rregullta në Vend dhe jashtë Vendit; 20,92

milion denarë apo 0,04% për pagesën e pensioneve minimale bujqësore dhe 340,90 milion denarë apo 0,63% për pagesën e pensioneve ushtarake.

1.1. Të dalat për pensionet e rregullta nga sigurimi i punës 53.865,90 milion denarë janë në kuadër të të planifikuarave 99,86%. Rritja e të dalave për pensione në raport të vitit 2017 ka të bëjë me harmonizimin e pensioneve prej 1,69% nga muaji janar dhe 1,80% nga korriku i vitit 2018. Në rritjen e të dalave për pensione kishin ndikim edhe ndryshimet të cilat shkaktoheshin në shumat e pensioneve me fluksin dhe defluksin e shfrytëzuesve të pensionit si dhe fluksi i shfrytëzuesve të rinj të pensionit në shkallë prej 1,56% në krahasim me vitin 2017.

1.2. Të dalat mbi pagesën e pensioneve për pensionet minimale bujqësore arrijnë 20,92 milion denarë dhe të njëjtat shënojnë reduktim prej 18,3% për shkak reduktimit të numrit të përfituesve të pensionit. Numri i shfrytëzuesve të pensionit me gjendje më 31.12.2018 arrin 215 dhe i njëjti në raport të vitit 2017 (271) është reduktuar për 56 përfitues apo për 20,66%.


1.3. Të dalat për pagesën e pensioneve ushtarake arrijnë 358,27 milion denarë dhe të njëjtat janë më të ulëta nga mjetet e planifikuara për 2,04%. Numri i përfituesve të pensionit ushtarak arrin 1.283 përfitues dhe i njëjti në raport të vitit 2017 është reduktuar për 100 përfitues apo për 7,2%.

Numri i përfituesve të pensionit me gjendje më 31 dhjetor të vitit 2018 dhe vitit 2017 arrin:

Numër rendor	Lloji i pensionit	31.12.2017	31.12.2018	Indeksi
1	Pension pleqërie	197.383	204.455	103,58
2	Pension invalidor	36.970	35.645	96,42
3	Pension familjar	76.391	75.680	99,07
	Gjithsej	310.744	315.780	101,62
4	Pension ushtarak	1.383	1.283	92,77
5	Pension bujqësor	271	215	79,34
	Gjithsej	312.398	317.278	101,56

Gjithsej numri i përfituesve të pensionit në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 është rritur për 1,62% dhe së bashku me pensionet minimale bujqësore dhe ato ushtarake rritja arrin 1,56% për shkak reduktimit të shfrytëzuesve të pensioneve minimale bujqësore dhe pensioneve ushtarake.

Struktura e numrit të shfrytëzuesve të pensionit është dhënë në grafikun e mëposhtëm:



Në kuadër të gjithsej numrit të përfituesve të pensionit, më i madh është numri i përfituesve të pensionit të pleqërisë apo 204.455 përfitues që përfaqëson më shumë se gjysma e numrit të përfituesve (64,44%), përfituesit e pensionit familjar arrijnë 75.680 përfitues me pjesëmarrje prej 23,85%, të pensionit invalidor 35.645 përfitues dhe me pjesëmarrje prej 11,23%, të pensioneve ushtarake 1.283 përfitues dhe pjesëmarrje prej 0,40% dhe të pensioneve minimale bujqësore 215 përfitues dhe pjesëmarrje prej 0,07%.

Rritje e numrit të përfituesve të pensionit në vitin 2018 është realizuar vetëm tek përfituesit e pensionit të pleqërisë edhe atë prej 3,58% dhe përfituesit e pensionit familjar ka reduktim për 0,39%, tek përfituesit e pensionit invalidor ka reduktim prej 3,58%, përderisa tek pensionistët ushtarak dhe bujqësore ka reduktim më të lartë. Në rritjen prej 3,58% e përfituesve të pensionit të pleqërisë ka ndikim edhe numri i rritur i

kërkesave të parashtruara dhe të zgjidhura për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë, gjegjësisht plotësimi i kushteve për arritjen e të drejtës së pensionit.

Pensionet mesatare (nga e drejta e punës) sipas llojeve, në dhjetor të vitit 2018 arrijnë edhe atë:

Lloji i pensionit	Viti 2018
Pension pleqërie	15.717
Pension invalidor	13.053
Pension familjar	11.563
Gjithsej	14.421
Pension bujqësor	7.154
Pension ushtarak	21.785
Gjithsej	14.445

Shuma mesatare e pensionit (nga sigurimi i punës) në dhjetor të vitit 2018 arrin 14.421 denarë dhe është rezultat i harmonizimit të kryer të pensioneve nga muaji janar i vitit 2018 me 1,69% dhe nga korriku 1,80%, si dhe në lartësinë e pensioneve të përfituesve të rinj të pensionit dhe të përfituesve të cilëve u ndërpritet e drejta.

Gjithsej pensioni mesatar me pensionet ushtarake dhe minimale bujqësore në dhjetor të vitit 2018 arrin 14.445 denarë edhe atë: 15.717 denarë pension pleqërie, 13.053 denarë pension invalidor dhe 11.563 denarë pension familjar.

Pjesëmarrja e gjithsej pensionit mesatar të paguar në dhjetor të vitit 2018 në pagën mesatare (25.784 denarë për muajin nëntor të vitit 2018) arrin 56,02%.

2. Të dalat për pagesën e kontributeve të anëtarëve në fondet pensionale private arrijnë 7.007,81 milion denarë. Këta të dala janë kryer në nivel të 99,05% në raport të mjeteve të planifikuara me Rebalancin e Buxhetit të Fondit dhe zbatimi i mjeteve prej një paragrafi në tjetër nga teprica e mjeteve). Numri i të siguruarve – anëtarë në fondet pensionale private në fund të 31.12.2018 arrinte 490.035 anëtarë

apo më shumë për 32.769 anëtarë apo 7,2%, për shkak antarësimit të detyrueshëm në fondet pensionale private të të gjithë të punësuarve të rinj. Të dalat për pagesë deri tek fondet pensionale private arrijnë 10,22% nga gjithsej të dalat e Fondit.

3. Të dalat për kompensim në të holla për dëmtim trupor arrijnë 86,49 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të dalat marrin pjesë me 0,13%. Kompensim monetar paguhet për 9.831 përfitues (1.808 përfitues me të drejtë të vetme dhe 8.023 përfitues me të drejtë të realizuar të pensionit).

4. Të dalat për kompensimet e të drejtave nga sigurimi invalidor arrijnë 3,77 milion denarë. Kompensimet nga sigurimi invalidor në vitin 2018 në krahasim me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit janë kryer me 94,25%.

5. Për vendosje në konvikt të fëmijëve invalid në vitin 2018 janë shpenzuar mjete në shumë prej 0,42 milion denarë dhe të njëjtat janë më të ulëta edhe me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit.

6. Për kontributin për sigurim shëndetësor të shfrytëzuesve të pensionit në vitin 2018 janë paguar mjete në shumë prej 6.827,33 milion denarë apo 10,08% në raport me gjithsej të dalat dhe është në nivel të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2018. Në mbështetje me Ligjin për kontributet e detyrueshme të sigurimit social, shkalla e kontributit arrin 13,0% e pensioneve të paguara. Duhet të theksohet se rreth 252,99 milion denarë mbetet kontribut i pa paguar për sigurim shëndetësor, përkatësisht si obligim u bart që të paguhet në janar të vitit 2018.

7. Pagat e punonjësve në Shërbimin profesional të Fondit dhe kompensimet në vitin 2018 arrijnë 232,19 milion denarë apo 0,34% në raport me gjithsej të dalat. Të dalat e kryera për pagat e punonjësve në Shërbimin profesional janë nën nivel të mjeteve të planifikuara për 1,67%, ndërsa vendet e zbrazëta nuk janë plotësuar me arsye se në mbështetje të masave antikrizë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nuk janë plotësuar këta vende pune të punëtorëve të pensionuar të Fondit.

8. Të dalat e tjera në vitin 2018 janë kryer në shumë prej 135,03 milion denarë apo 0,20 në raport me gjithsej të dalat. Këta shpenzime në raport me të planifikuarat janë kryer me 85,73%. Shpenzimet e kryera i dedikohen edhe atë: 50,93 milion denarë për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport; 10,59 milion denarë për materialin e zyrave, mjete për higjienë dhe material për AOP; 26,17 milion denarë për përmirësime dhe servisimin e softuerit dhe pajisje tjera, të veturave, si dhe mirëmbajtje rrjedhëse të objekteve afariste, 28,26 milion denarë për provizion bankar, për pagat e punonjësve me kontratë në vepër, për tatim personal për kontratat në vepër, për shërbime të kopjimit dhe shtypjes së materialeve, pagesë të taksave gjyqësore, për sigurimin e patundshmërisë dhe të të drejtave dhe të tjera; 3,62 milion denarë për të dala tjera rrjedhëse (për reprezentacion, për mikrofilmimin e të dhënave për stazhin e sigurimit dhe pagat në evidencën amë të Fondit, 0,87 milion denarë për të dalurat e udhëtimit, 14,59 milion denarë për pagesat e dokumenteve ekzekutive dhe shpenzime tjera.

9. Shpenzimet kapitale janë kryer në shumë prej 14,90 milion denarë të cilat në krahasim me mjetet e planifikuara për këtë qëllim (në shumë prej 16,5 milion denarë) janë kryer me 90,3%. Në vitin 2018 këta mjete janë shpenzuar për blerjen e pajisjeve informatike dhe pajisjeve të zyrave.


10. Shpenzimet për rikonsdtruimin e objekteve afariste janë realizuar në shumë prej 7,14 milion denarë, me Buxhet ishin paraparë 8,47 milion denarë edhe atë për rikonstruimin e objekteve në Strumicë, Manastir, M.Brod, Gostivar dhe Qendrën - Shkup, në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit në Gostivar, Autokomandë dhe Gjorçe Petrov - Shkup.

11. Furnizimi i automjeteve (1 kombe) është bërë për nevojat e Shërbimit profesional të Fondit nuk posedonte një veturë adekuate për transport të personave zyrtarë në të shumtën e rasteve për njëherë dhe për transport të materialit për zyrë ejt., deri te filialet dhe ekspoziturat e Vendit. Furnizimi është realizuar në shumë prej 1,40 milion denarë po aq sa janë paraparë mjete.

Gjithsej të dalat e Fondit janë paraqitur në tabelën vijuese:

Nr.R.	Lloji i të dalave	Buxhet për vitin 2018	Të realizuar I-XII 2017	Të realizuar I-XII 2018	Indeks 4:2	Indeks 4:3
0	1	2	3	4	5	6
1	Gjithsej pensione dhe dëmtim trupor	54.317,00	51.906,22	54.314,21	99,81	104,64
2	Pages në bazë të sig. të detyr. kap.	7.075,00	6.253,13	7.007,81	99,05	112,07
3	Kompensime nga sigurimi invalidor	4,00	4,48	3,77	94,25	84,15
4	Kontribut për sigurim shëndetësor	6.830,00	6.571,28	6.827,33	99,96	103,90
5	Paga dhe kompensime	233,0	241,88	232,19	99,65	96,00
6	Të dala tjera, shpenzime kapitale dhe rikonstruimi i objekteve afariste	186,00	171,95	158,89	85,42	92,40
	Gjithsej të dala	68.645,00	65.148,94	68.544,20	99,85	105,21

Struktura e gjithsej të dalave të Fondit paraqitet në vijim



Në strukturën e gjithsej të dalave më e madhe është pjesëmarrja e të dalave për pensionet dhe dëmtim trupor prej 79,24% dhe për të dalat për kontributet e sigurimit shëndetësor prej 9,96% apo pjesëmarrja e bruto pensioneve në gjithsej të dalat arrin 89,20%. Të dalat e tjera marin pjesë edhe atë: 10,22% nga pagesa në bazë të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital, 0,01% nga kompensimet

monetare nga sigurimi invalidor, 0,34% nga pagat e të punësuarve dhe kompensimet dhe 0,23% nga të dalat e tjera.

III. Rezultate financiare

Në vitin 2018, Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 68.852,47 milion denarë dhe gjithsej të dala prej 68.544,20 milion denarë apo tepricë të të hyrave në shumë prej 308,27 milion denarë. Me mjetet e bartura monetare nga viti 2017, saldoja e mjeteve monetare më 31.12.2018 arrin 1.661,70 milion denarë.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut dhe Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2018, Fondi në tërësi dhe në kohë ka kryer të gjitha aktivitetet në mbështetje me ligjin, përkatësisht pagesë të rregullt dhe në kohë të pensioneve në javën e parë të muajit si dhe kontributet për shëndetësi për shfrytëzuesit e pensionit dhe shpenzimet e Shërbimit profesional.

Shkup, shkurt viti 2018

Përktheu: Makfire Haskaj